FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR

DURRËS Nr. 01/2026
16.06.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 1-të e Bordit të FSSHK-së, mbajtur më 16.06.2026 me fillim prej orës 15:00 në Bonita Luxory Golem.
Prezent: Adrian Telaku (kryetar), Skender Ramadani (nënkryetar), Gazmend Ahmeti, Ruzhdi Koca, Rudina Berisha, Ylli Maloku, Milot Haziri Leonard Cula, Rifadije Berisha, Lejla Boshnjak dhe Agron Dubovci (sekretari i përgjithshëm)
Mungoi: Labinot Metaj

Pasi i përshëndeti të pranishmit kryetari i FSSHK-së, propozoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.08.2025
2. Raportimi i përfaqësuesve të regjionave për garat e rregullta të kalendarit 2025/26.
3. Të ndryshme

Rendi i ditës u aprovua unanimisht.

-I-

Procesverbali i mbledhjes së datës 26.06.2025 u miratua pa asnjë vërejtje

-II-

Pika e dytë kishte të bënte me raportimin e përfaqësuesve të regjioneve për garat e rregullta të kalendarit vjetor 2025/26.

Regjioni i Prishtinës - Gazmend Ahmeti.- Garat e regjionit të Prishtinës janë mbajtur të gjitha duke e respektuar kalendarin e garave me ndonjë ndryshim të vogël me marrëveshje me kryetarët e shoqatave të këtij regjioni.
Hendbolli dhe basketbolli si dy sporte atraktive po ka pak interesim te shkollat e mesme të ulëta, kurse te ato të larta interesimi është pak më i lartë por jo ai që kishim dëshiruar. Te garat e Futsallit kemi pas disa probleme të vogla në referim dhe ka pasur një ankesë, por kjo vërejtje ka kaluar pa ndonjë pasoj, sepse u konstatua se gjyqtari ka bërë lëshim në kohën e lojës.

FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR

Një vërejtje tjetër ishte nga shkolla “Pavarësia” në ndeshjet e basketbollit, por në fund u konstatua se gjyqtari ka pasur të drejtë dhe se ai e ka krye punën e tij më së miri.
Problem tjetër ishte edhe mbajtja e garave në të njëjtën kohë në dy palestra, të shikohet mundësia që këto gara mos të mbahen kështu sepse është e pamundur që përfaqësuesi i regjionit ta monitorojë aktivitetin, ai theksoi gjithashtu se në regjionin e Prishtinës ka shumë mungesë të punëtorëve sportive.

Adrian Telaku.- gjyqtarët që kanë bërë probleme në garat e futsallit të sanksionohen për ndarjen jo të drejtë të drejtësisë, dhe të përjashtohen nga aktivitetet e federatës sonë, ai tha se si rekomandim nëse zhvillohen dy gara në të njëjtën kohë në dy palestra të ndara, të kërkohet ndihma nga përfaqësuesi i regjionit tjetër, ose nga ndonjë anëtar i bordit.

Regjioni i Prishtinës - Gazmend Ahmeti.- Gjimnaziada “Peja 2025” Garat republikane për shkollat e mesme të ulëta janë zhvilluar dhe kanë përfunduar pa ndonjë problem të madhë, kanë qenë dy raste që duhet cekur, njëra ishte me mësimdhënësin Fidan Tmava, ku ishte i pakënaqur me gjyqtarin dhe ka hyrë në fushë, ka bërë reagim jo sportiv, dhe se situata në atë moment gati sa nuk eskaloj, dhe rasti tjetër ishte me shikuesit e shkollës “Tafil Ksumaj” nga Deçani, ku nxënësit e kësaj shkolle shanin dhe ofendonin shokët e tyre për lojën e dobët të treguar në fushë.

Kurse te garat republikane në basketboll për SHMU, kanë qenë disa gabime teknike ku përfaqësuesi i Prishtinës nuk i ka njoftuar shkollat e komunës së tij për gara, disa shkolla me fanella pa numra dhe disa nxënës me libreza të pavulosura.

Regjioni i Mitrovicës.- Ruzhdi Koca.- Garat ne regjionin e Mitrovicës kanë shkuar sipas planifikimit me disa përjashtime të vogla, garat në sportet kolektive që dy vite nuk i mbajmë në Vushtrri, kurse disa probleme të vogla i kemi pasur në basketboll që janë mbajtur në Mitrovicë, ekipi i një shkolle është udhëhequr nga një mësimdhënës i një shkolle tjetër, i cili ka munguar për arsye shëndetësore.

Kurse sa i përket organizimit të Gjimnaziadës “Peja 2026” në aspektin sportiv garues ka shkuar gjithçka sipas planifikimit, por vetëm te organizimi ka pasur mungesa të informatave se ku do të vendosen (akomodohen) nxënësit.

Regjioni i Prizrenit.- Rudina Berisha.- Kryesisht edhe garat e regjionit të Prizrenit kanë shkuar mirë, ka pasur disa vërejtje në organizim e garave të basketbollit, por përfaqësuesi i regjionit nuk i ka cekur në raportin e tij.

Regjioni i Ferizajt.- Ylli Maloku.- Janë mbajtur të gjitha garat sipas kalendarit vjetor, kemi pasur disa probleme që kryesisht i ka shkaktuar mësimdhënësi Fidan Tmava, i cili në garën e futsallit për shkollat e mesme të larta ka qenë iniciator i problemit, ku është dashur të ndërhyj edhe policia, publiku ka gjuajtur në parket me mjete të forta. I njëjti ka bërë probleme edhe në garat e volejbollit.

Kemi pasur disa probleme teknike që kishin të bëjnë me çështjen e librezave, por që janë tejkaluar shpejt.

Sa i përket organizimit të Gjimnaziadës "Peja 2026" edhe këtu organizimi i ndeshjeve ka shkuar sipas planifikimit, por në fillim kemi pasur disa probleme teknike si: mungesa e rekuizitave, mungesa e gjyqtarëve e që u kompensua shumë shpejt, por kanë munguar edhe rrethojat e tabelave e që na ka marrë shumë kohë zhvillimi i ndeshjeve.

Regjioni i Gjilanit.- Milot Haziri.- kam qenë pjesëmarrës i të gjitha garave të regjionit tonë, të gjitha kanë përfunduar pa ndonjë vërejtje nga pjesëmarrësit. Kemi pasur pak vështirësi në organizim sepse palestra e qytetit të Gjilanit është në renovim, dhe garat i kemi mbajtur nëpër palestrat e komunave tjera. Edhe te regjioni i Gjilanit një vërejtje për përfaqësuesin e regjionit, i cili nuk i ka përshkruar disa probleme të vogla në raportin e tij të garave.

Te garat republikane gjimnaziada "Peja 2026" organizimi i garës ka qenë i mirë, për veç disa çështjeve teknike si vendi i mbajtjes së garave, e cila na ka shkaktuar vonesa me fillim e garës me kohë.

Regjioni i Gjakovës.- Leonard Cula.- edhe në regjionin e Gjakovës garat janë mbajtur sipas kalendarit vjetor, dhe në dakordim të plotë me kryetarët e dy shoqatave tjera nga Juniku dhe Rahoveci, në të tri komunat i kemi mbajtur nga dy disiplina sportive. Çdo gjë ka shkuar sipas planifikimit dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje nga përfaqësuesit e asnjë shkolle që ka marrë pjesë në gara.

Në Gjakovë janë mbajtur edhe garat republikane në Shah për shkollat e mesme të ulëta, edhe kjo garë ka përfunduar pa asnjë vërejtje.

Sa i përket Gjimnaziadës "Peja 2026" kam qenë komisar në garat e basketbollit, për dy ditë rresht janë zhvilluar ndeshje shumë kualitative, te konkurrenca e meshkujve kanë munguar shkolla "Remzi Ademaj" nga Prizreni kurse me meritë kampion të kësaj gare janë shpallur tek vajza gjimnazi "Gjon Buzuku" nga Prizreni kurse tek djemtë gjimnazi "Sami Frashëri" nga Prishtina.

Pas raportimit të përfaqësuesve të regjioneve, kryetari e qiti në votim raportin e përgjithshëm të garave për vitin shkollor 2025/26, i cili **aprovohet, nga të gjithë të pranishmit**.

-III-

Në të ndryshme kryetari informojë anëtarët e bordit për mbajtjen e kampionatit botëror "Shkupi 2026", organizimin e mirë të kampionatit, por pjesëmarrësit shumica prej tyre kanë marrë pjesë me reprezentacione, kurse ne me shkollat fituese të garave republikane, me vajza gjimnazi "Eqrem Çabej" nga Vushtrria dhe me djem gjimnazi "Vëllezërit Frashëri" nga Deçani.

Për shkak të shpenzimeve të larta nuk ja vlen të merret pjesë në kampionate të tilla, do ta shqyrtojmë mundësinë që ekipet fituese ti shpërblejmë me dy-tri ditë në bregdetin shqiptar, por për këtë do të vendosim në fillim të vitit të ri shkollor.

REKOMNADIMET:

Vërejtje.- shkollës **"Tafil Kasumaj"** nga Deçani për sjelljet jo të mira në ndeshjet e organizuara në Deçan në kuadër të gjimnaziadës në garat e futsallit.

Vërejtje.- shkollës **"Remzi Ademaj"** nga Prizreni për mospjesëmarrje në garat republikane gjimnaziada "Peja 2026" në basketboll me djem.

Vërejte.- Mësimdhënësit **Fidan Tmava**, të merret vendimi në përputhje me rregulloret disiplinore për sjelljet e vazhdueshme të pahijshme gjatë organizimit të garave.

- Të përgatitet një platformë për regjistrimin e nxënësve
- 72 orë para mbajtjes së garave të konfirmohet pjesëmarrja e shkollave
- Shkollat pjesëmarrëse në garat regjionale t'i kenë patjetër të kryera vizitat mjekësore të nxënësve pjesëmarrës në gara.

Mbledhja përfundoi në 18:30

FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR REPUBLIKA E KOSOVËS FSSHRK REPUBLIC OF KOSOVA SCHOOL SPORTS FEDERATION

Procesmbajtës:

Leonard CULA